

VENDIM
Nr. 240, datë 22.9.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 194, DATË 21.7.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘GREEN ENERGY BILISHT’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME VENDNDODHJE NË ZONËN BITINCKË, BILISHT, QARKU KORÇË, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, PËR NJË AFAT 25-VJEÇAR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1539/7 prot., datë 20.9.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin nr. 194, datë 21.7.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Green Energy Bilisht’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 194, datë 21.7.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “Green Energy Bilisht” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Në pikën 3 të dispozitivit të këtij vendimi përcaktohet se: “3. Shoqëria “Green Energy Bilisht” sh.p.k. të depozitojë në ERE, brenda 30 ditëve pune nga marrja dijeni, dokumentacion për mbulimin e pjesës së mbetur të investimit për ndërtimin e centralit fotovoltaik.”.

- Me shkresën nr. 448/6 prot., datë 27.7.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje, duke i kujtuar detyrimin për të plotësuar kushtin, sikurse përcaktuar në vendimin nr. 194/2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 448/8, datë 13.9.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit të sipërcituar.

- Me plotësimin e kushtit, pika 3 e vendimit nr. 194/2022 shfuqizohet.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 3, të vendimit nr. 194, datë 21.7.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Green Energy Bilisht’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që

mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti